



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRI

Adresa: Blv. “ Bajram Curri” Nr 1 Tirana – Albania, Tel/fax.00 355 4 36 29 37 www.moh.gov.al

U D H Ë Z I M

NR. 05 DATË 09 janar 2012

**“MBI KRITERET E PËRZGJEDHJES SE DREJTORIT TË QENDRËS
SHËNDETËSORE”**

Bazuar në VKM nr. 520 datë 9.06.2010 “ Për disa ndryshime në VKM nr. 857 datë 20.12.2006 “Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor” e ndryshuar, nenin 25 të Rregullores se Përgjithshme për kontraktimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor, përzgjedhja e drejtorit të qendrës shëndetësore nga bordi i qendrave shëndetësore në nivel DSHP/ASHR, kryhet në bazë të këtyre kriterëve :

- 1- Të jetë i diplomuar nga Fakulteti i Mjekësisë.
- 2- Të ketë mbi 5 vjet përvojë pune në një qendër shëndetësore.
- 3- Të ketë përparësi kryerja e trainimeve në mjekësinë familjare si dhe ato në fushën e menaxhimit shëndetësor.
- 4- Të ketë vlerësime pozitive të punës së tij ndër vite.
- 5- Të njohë së paku një gjuhë të huaj dhe detyrimisht të përdorë kompjuterin.
- 6- Te paraqesë nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim numrin e krediteve të paracaktuara për t’u plotësuar.
- 7- Udhëzimi nr. 463/1 datë 26.8.2010 shfuqizohet.

Kandidatët konkurues të paraqesin kërkesën, CV dhe dëshmitë e kualifikimeve pranë Bordit të Qendrave Shëndetësore në nivel DSHP/ASHR.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
PETRIT VASILI